FAKULTETI I FILOLOGJISË

PLANI STRATEGJIK 2025-2029

FAKULTETI I FILOLOGJISË

Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren

Rr. Shkronjave 1, 20000 Prizren

Republika e Kosovës

Tetor 2025

SHKURTESAT

UUHP	Universiteti ‘‘Ukshin Hoti” Prizren
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
SHU	Shoqata e Universiteteve
MM	Memorandum Mirëkuptimi
BE	Bashkimi Evropian
ZBN	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar
ZSC	Zyra për Sigurim të Cilësisë
QKA	Qendra e Karrierës dhe Alumnit
BKI	Bordi Këshillëdhënës Industrial
TI	Teknologjia e Informacionit
ZDTD	Zyra për Transfer të Dijes dhe Teknologjisë
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Teknologjisë
NJA	Njësitë Akademike

PËRMBAJTJA

Fjala e dekanit

Historik i shkurtër i Fakultetit të Filologjisë

1. **Themelet e planit strategjik**
   - 1.1. Misioni
   - 1.2. Vizioni
   - 1.3. Vlerat
   - 1.4. Palet e interesit
2. **Procesi i planifikimit strategjik**
   - 2.2. Analiza e pozicionimit
3. **Prioritetet strategjike**
   - 3.1. Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
   - 3.2. Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore;
   - 3.3. Zhvillimi i kapaciteteve akademike për programin Master në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Angleze dhe gjermane;
   - 3.4. Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit;
   - 3.5. Zhvillimi i infrastrukturës;
   - 3.6. Kontributi i Fakultetit të Filologjisë në komunitet dhe komercializimi i kërkimit;
4. **Plani i veprimit**

FJALA E DEKANIT

Në cilësinë e Dekanes së Fakultetit të Filologjisë të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, kam kënaqësinë e veçantë të prezantoj Planin Strategjik 2025–2029 – një dokument orientues që përcakton vizionin, prioritetet dhe drejtimet zhvillimore të Fakultetit për pesëvjeçarin e ardhshëm.

Fakulteti i Filologjisë, që nga themelimi i tij në vitin 2014, është konsoliduar si një qendër e rëndësishme e dijes humanistike, e cila ndërthur traditën akademike me përkushtimin ndaj inovacionit dhe ndërkombëtarizimit. Me tri programe studimi në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Gjuhë dhe Letërsi Angleze dhe Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, Fakulteti ynë synon të formojë profesionistë kompetentë, kërkues kritikë dhe qytetarë aktivë të shoqërisë moderne.

Ky Plan Strategjik reflekton angazhimin tonë për ngritjen e mëtejshme të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe njerëzore, si dhe për thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Ai është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës, ku janë përfshirë stafi akademik e administrativ, studentët, alumni dhe partnerët tanë strategjikë vendorë e ndërkombëtarë.

Fakulteti i Filologjisë mbetet i përkushtuar të jetë një hapësirë e dijes, kulturës dhe mendimit kritik, duke ndërtuar ura bashkëpunimi ndërmjet akademisë dhe shoqërisë. Me përkushtim, profesionalizëm dhe vizion të përbashkët, do të vazhdojmë të afirmojmë rolin e Fakultetit si një prej qendrave më dinamike të studimeve filologjike në Kosovë dhe më gjerë.

Prof. asoc. dr. Vjollca Dibra
U.d. dekane e Fakultetit të Filologjisë

HARTIMI I PLANIT STRATEGJIK

Ky plan strategjik është hartuar në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues të UUHP me Ref. 05-14, datë 15.9.2025.

Plani Strategjik 2025-2029 është hartuar pas konsultimeve intensive dhe gjithëpërfshirëse të akterëve të brendshëm dhe të jashtëm të Fakultetit të Filologjisë të UUHP. Të gjitha aktivitetet zhvillimore të Fakultetit të Filologjisë UUHP do të mbështeten dhe udhëhiqen nga ky plan strategjik.

Anëtarët e komisionit të hartimit të planit strategjik

Prof. ass. dr. Dorinë Rakaj, kryetare
Prof. asoc. dr. Ilir Krusha, anëtar
Prof.ass.dr. Shpetim Zymberaj, anëtar
Prof. asoc. dr. Vjollca Dibra, anëtare
Prof. dr. Sejdi Sejdiu, anëtar
Prof. ass. dr. Manjola Brahaj, anëtare
Prof.asoc.dr. Flamur Shala, anëtar
Prof. ass. dr. Rezarta Ramadani, anëtare
Azra Thaqi (përfaqësuese e Alumnit), anëtare
Klea Hazrolli, (përfaqësuese e studentëve), anëtare
Nexhat Maqkaj, nga jashtë (DKA), anëtar

HISTORIKU I FAKULTETIT TË FILOLOGJISË

Fakulteti i Filologjisë u themelua në vitin 2014.

Në Fakultetin e Filologjisë janë regjistruar **5,511** studentë që nga fillimi i punës, në vitin e parë akademik (2014/15).

Fakulteti i Filologjisë organizon programet për studime në nivelin bachelor. Brenda një periudhe afatmesme planifikon të hapë programin e studimeve master.

Programet e studimeve në nivelin bachelor:

- Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
- Gjuhë dhe Letërsi Angleze
- Gjuhë dhe Letërsi Gjermane

Kërkimet shkencore dhe rezultatet e stafit akademik maten me plasimin e punimeve shkencore në revista ndërkombëtare të indeksuara në platformat e publikuara sipas Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, si SCOPUS dhe Web of Science.

Infrastruktura e Fakultetit të Filologjisë
Fakulteti i Filologjisë aktivitetin e tij akademik e zhvillon në objektin e ish Shkollës së Lartë Pedagogjike, më vonë Fakulteti i Edukimit dega në Prizren dhe aktualisht është objekti i përbashkët me Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prizrenit. Fakulteti i Filologjisë ka 8 klasë-salla mësimi të pajisura me video-projektorë, 7 zyra të personelit akademik, 2 zyra të administratës, një sallë të përbashkët të mbledhjeve dhe amfiteatrin e përbashkët me Fakultetin e Edukimit. Ka bibliotekën e specializuar të gjermanistikës-këndi austriak dhe Bibliotekën e përbashkët për të gjitha njësitë akademike.

1. THEMELET E PLANIT STRATEGJIK

1.1. Misioni

Fakulteti i Filologjisë ka për qëllim që përmes programeve studimore të të ofrojë edukim cilësor në dimensionin profesional, kërkime shkencore dhe kontribut në komunitet, duke përgatitur kuadro nga fusha e filologjisë, përkatësisht nga dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, Gjuhës dhe Letërsisë Angleze dhe Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, të cilët do të shërbejnë në institucionet publike, sektorin privat dhe në shoqëri.

1.2. Vizioni

Fakulteti i Filologjisë në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, si institucion i Arsimit të Lartë ka për qëllim ofrimin e dijës për studentet në fushën e filologjisë dhe aftësimit të tyre gjuhësor e komunikativ për tregun e punës dhe integrimin në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, ku dija dhe kërkimi shkencor janë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm kulturor, shoqëror dhe ekonomik. Ky vizion synon ta shndërroj Fakultetin e Filologjisë në vatër të aftësimit, dijes dhe vlerave të mira në formim të gjeneratave të reja profesionale.

1.3. Vlerat

Vlerat e Fakultetit të Filologjisë janë: mësimi sistemor i tri gjuhëve, shqipe, angleze dhe gjermane, i letërsisë shqipe, angloamerikane dhe gjermane. Mësimi me standarde evropiane të arsmit të lartë: programe me objektiva, përfshirë rezultatet mësimore të synuara; programe inkurajuese për studentët që të kenë rol aktiv në procesin mësimor; bashkëpunimi me partnerë, mobilitetiti; punësimi i studentëve dhe të diplomuarve, e sidomos ofertat për punësim në gjuhën gjermane dhe angleze.

1.4. Palët e interesit

Palët e interesit të Fakultetit të Filologjisë:
Të brendshme: stafi akademik; stafi administrativ dhe teknik; menaxhmenti i njësisë akademike.

STAFI AKADEMIK

Stafi akademik përbën bartësit kryesorë të procesit edukativ dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore. Ky grup i interesit përfaqësohet nga profesorët e rregullt, profesorët e angazhuar, asistentët dhe bashkëpunëtorët shkencorë. Stafi akademik i rregullt kategorizohet sipas thirrjes akademike në prof. dr, prof. asoc. dr., prof. ass. dr. dhe ass.

STAFI ADMINISTRATIV DHE TEKNIK

Stafi administrativ dhe teknik përbën palët e brendshme të interesit të cilët kryejnë funksionet operative dhe teknike të Fakultetit të Filologjisë.

- Sekretari
- Zyrtarët për shërbime studentore
- Bibliotekari

MENAXHMENTI I FAKULTETIT TË FILOLOGJISË

Menaxhmenti i Fakultetit të Filologjisë përbën organet udhëheqëse, që përkujdesen për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, punës kërkimore-shkencore, zhvillimit profesional të mësimdhënësve, konferencave shkencore, simpoziumeve, etj.

- Dekani
- Prodekani
- Shefat për mësim
- Këshilli i Fakultetit

Të jashtme: studentët; alumni (studentët e diplomuar); shoqëria civile (OJQ); komuniteti shkollor; komuniteti shkencor; institucionet qeveritare lokale, nacionale e ndërkombëtare.

STUDENTËT

Studentët janë përfituesit kryesor të procesit të përvetësimit dhe transferit të dijes funksionale. Këtë grup të interesit e përbëjnë studentët e rregullt vendorë dhe ata ndërkombëtarë.

ALUMNI (STUDENTËT E DIPLOMUAR)

Alumni janë studentët e diplomuar, të cilët vazhdojnë t'i gëzojnë shërbimet e Fakultetit të Filologjisë si dhe të kontribuojnë në lidhjen e urave të komunikimit të Fakultetit me komunitetin e jashtëm. Ky grup i interesit mund të krijojë komunitetin e vet pas përfundimit të studimeve.

KOMUNITETI

Komuniteti është palë strategjike e interesit e cila përbëhet nga Institucionet shkollore, Drejtoritë Komunale të Arsimit, Institutet hulumtuese, MAShTI, OJQ-të dhe shoqëria civile.

AUTORITETI QEVERITAR LOKAL DHE QENDROR

Autoriteti qeveritar, në nivel lokal dhe qendror, është akter i rëndësishëm në zbatimin e Planit Strategjik 2025-2029. Në këtë kuadër përfshihen përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, DKA-së, institucionet shkollore, etj.

KOMUNITETI I JASHTËM AKADEMIK DHE SHKENCOR

Komuniteti i jashtëm akademik dhe shkencor përbëhet nga partnerët e jashtëm strategjik, duke përfshirë institucionet shkollore, institutet hulumtuese, bashkëpunimit mes fakulteteve të filologjisë, bashkëpunimin ndërkombëtarë me Fakultetin e Filologjisë.

Statistika të përmbledhura

Paraqitja grafike (me diagrame) e statistikave kryesore lidhur me çështjet me interes të veçantë për Fakultetin e Filologjisë:

- Statistikat lidhur me numrin i studentëve të regjistruar në vitin e parë sipas viteve, që na themelimi:

Viti akademik	Gjinia	Gjuhë shqipe	Gjuhë angleze	Gjuhë gjermane	Gjithsej
2014/15	F.	86	119	81	286
	Gj.	**122**	**155**	**180**	**457**
2015/16	F.	112	129	140	381
	Gj.	**146**	**242**	**182**	**570**
2016/17	F.	91	145	89	325
	Gj.	**131**	**206**	**153**	**490**
2017/18	F.	95	92	103	290
	Gj.	**109**	**102**	**117**	**328**
2018/19	F.	78	70	63	211
	Gj.	**95**	**96**	**99**	**290**
2019/20	F.	0	0	0	0
	Gj.	**0**	**0**	**0**	**0**
2020/21	F.	71	66	0	137
	Gj.	**93**	**98**	**0**	**191**
2021/22	F.	35	71	77	183
	Gj.	**40**	**114**	**100**	**254**
2022/23	F.	32	91	80	203
	Gj.	**39**	**118**	**99**	**256**
2023/24	F.	27	71	69	167
	Gj.	**30**	**98**	**87**	**215**
2024/25	F.	31	85	84	200
	Gj.	**34**	**106**	**97**	**247**
					5,511

Dega	Gjinia	2018/19	2019/20	2020/21	2021/22	2022/23	2023/24	Gjith.
Gjuhë shqipe	F.	24	35	23	42	22	27	173
	M.	2	13	5	2	0	3	25
	Gj.	**26**	**48**	**28**	**44**	**22**	**30**	**198**
Gjuhë angleze	F.	40	64	41	50	25	16	236
	M.	6	9	10	2	3	3	33
	Gj.	**46**	**73**	**51**	**52**	**28**	**19**	**269**
Gjuhë gjermane	F.	18	18	23	24	21	14	118
	M.	8	5	5	3	1	5	27
	Gj.	**26**	**23**	**28**	**27**	**24**	**19**	**147**
								614

Personeli akademik sipas titujeve:	
Prof.dr.	1
Prof.asoc.	7
Prof.ass.	5
Gj.	**13**
Stafi administrativ	
Sekretar	1
Zyrtar administrativ	1
Gj.	**2**

11

vjet
nga
themelimi

Fakulteti

3
Programe

3
Gjuhë

Fakulteti

3
Programe

3
Gjuhë

13

profesorë të
rregullt

Fakulteti

3
Programe

3
Gjuhë

Fakulteti

3
Programe

3
Gjuhë

4. PROCESI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Planifikimi strategjik i Fakultetit të Filologjisë

Fushat me prioritet strategjik

Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie/mësimnxënie

Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore

Zhvillimi i kapaciteteve akademike për programin Master në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe dhe Letërsi Angleze

Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit

Zhvillimi i infrastrukturës

Kontributi në komunitet dhe komercializimi i kërkimit

PRIORITETET STRATEGJIKE

Plani Strategjik 2025-2029 i Fakultetit të Filologjisë ka identifikuar këto fusha me prioritet strategjik:



Përparësitë

- **Mësimi i gjuhës dhe letërsisë shqipe, i gjuhës dhe letërsisë angleze dhe gjermane sipas standardeve evropiane bashkëkohore;**
- **Administratë efikase;**
- **Biblioteka për mësim dhe mundësia e përdorimit të librave;**
- **Personeli akademik i kualifikuar;**
- **Praktika profesionale në bashkëpunim me organet arsimore të komunës.**

Dobësitë

- **Investime të vogla për mobilitete- për mësimdhënës dhe studentë**
- **Përgatitje e pamjaftueshme paraprake e studenteve**
- **Përdorimi i tepërt (i pakët) i internetit- shmangie nga libri**
- **Numër relativisht i vogël i stafit të rregullt akademik**

Mundësitë

- **Infrastrukturë e përshtatshme;**
- **Mësimdhënia dhe mësimnxënia cilësore;**
- **Mobiliteti i personelit akademik dhe i studentëve;**
- **Ngritja e cilësisë së kërkimeve shkencore;**
- **Përfshirja në projekte ndërkombëtare (Erasmus+, COST, SHER, DAAD, Fulbright, Horizon, etj.)**

Rreziqet

- **Shpërputhje me kërkesat e tregut të punës;**
- **Raport i disfavorshëm ndërmjet numrit të stafit të rregullt akademik dhe studentëve;**
- **Braktisja e studimeve-migrimi i studentëve**

2. PRIORITETET STRATEGJIKE

Përmbledhje e shkurtër

Prioritetet strategjike për zhvillimin e Fakultetit të Filologjisë janë: Mësimdhënia/mësimnxënia dhe kontrolli i cilësisë; Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore; Kontributi në komunitet dhe komercializimi i kërkimit në komunitetin në të cilin vepron (aktivitetet në shërbim të komunitetit); Ndërkombëtarizimi dhe rrjetëzimi i Fakultetit të Filologjisë (marrëveshjet e bashkëpunimit, me prioritet ato fakultete të huaja prej të cilave është adaptuar 70% e programeve studimore; mobiliteti i stafit akademik dhe sudentëve etj.);

2.1. Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti i Filologjisë ka përcaktuar këto objektiva specifike:

- Objektivi specifik 1: Ngritja e kapaciteteve akademike në Fakultetin e Filologjisë;
- Objektivi specifik 2: Ngritja e cilësisë së matjes së rezultateve dhe monitorimit;
- Objektivi specifik 3: Ngritja e kapaciteteve administrative;
- Objektivi specifik 4: Ngritja e cilësisë së monitorimit të vlerësimit.

2.2. Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti i Filologjisë ka përcaktuar këto objektiva specifike:

- Objektivi specifik1: Përmirësimi i cilësisë së punës kërkimore;
- Objektivi specifik 2: Integrimi i hulumtimeve shkencore në procesin akademik;
- Objektivi specifik 3: Përfshirja e studentëve në projekte hulumtuese shkencore;
- Objektivi specifik 4: Botimi e revistës shkencore të Fakultetit të Filologjisë;
- Organizimi i konferencave shkencore.

2.3. Zhvillimi i kapaciteteve akademike për programet Master në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Gjuhë dhe Letërsi Angleze dhe Gjuhë dhe Letërsi Gjermane

- Objektivi specifik 1: Zhvillimi i programeve master shkencor në programet e studimit Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Gjuhë dhe Letërsi Angleze dhe Gjuhë dhe Letërsi Gjermane;
- Objektivi specifik 2: Akreditimi i programeve master shkencor në programet e studimit Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Gjuhë dhe Letërsi Angleze dhe Gjuhë dhe Letërsi Gjermane.

2.4. Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti i Filologjisë ka përcaktuar këto objektiva specifika:

- Objektivi specifik 1: Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar;
- Objektivi specifik 2: Shtimi i mobiliteteve të stafit akademik dhe studentëve;
- Objektivi specifik 3: Ndërkombëtarizimi i programeve.

2.5. Zhvillimi i infrastrukturës

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti i Filologjisë ka përcaktuar këto objektiva specifike:

- Objektivi specifik 1: Zhvillimi (përmirësimi) i infrastrukturës fizike;
- Objektivi specifik 2: Ngritja e laboratorëve fonetikë;
- Objektivi specifik 3: Pajisja me teknologji informative.

2.6. Kontributi i Fakultetit të Filologjisë në komunitet dhe komercializimi i kërkimit

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti i Filologjisë ka përcaktuar këto objektiva specifike:

- Objektivi specifik 1: Zhvillimi i bashkëpunimit me komunitetin shkollor të Prizrenit;
- Objektivi specifik 2: Zhvillimi i bashkëpunimit kulturor me Komunën e Prizrenit;
- Objektivi specifik 3: Zhvillimi i kërkimeve të studentëve në komunitet;
- Objektivi specifik 4: Shkëmbime ndërkulturore me komunitete.

Kampusi i UUHP-së

Infrastruktura e UUHP-së

- **25,000 m²** Kampusit universitar
- **14,820 m²** Hapësira e infrastrukturës
- **1,701 m²** 4 Amfiteatro
- **3,068 m²** 40 Salla të mësimit
- **527 m²** 3 Biblioteka
- **476 m²** 9 Laboratore
- **356 m²** 3 Kabinete të informatikës
- **1,423 m²** 47 zyra administrative dhe stafit akademik
- **7,269 m²** Hapësira ndihmëse

FJALA PËRMBYLLËSE

Fakulteti i Filologjisë do të vazhdojë t'i zhvillojë kapacitetet për rekrutimin dhe zhvillimin e studentëve për të diplomuar, për të qenë të gatshëm për tregun e punës në Republikën e Kosovës, në rajon dhe më gjerë. Në periudhën 2025-2029, Fakulteti synon të avancojë në zbatimin e plotë të parimeve të Procesit të Bolonjës, duke u bërë një ndër njësitë akademike më konkurruese dhe tërheqëse për studime gjuhësore dhe letrare në vend. Mësimi sistemor i tri gjuhëve, shqipe, angleze dhe gjermane, i letërsisë shqipe, angloamerikane dhe gjermane, me programe me objektiva, përfshirë rezultatet mësimore të synuara, me programe inkurajuese për studentët, që të kenë rol aktiv në procesin mësimor; bashkëpunimi me partnerë dhe mobilitetit, shënojnë disa nga vlerat e Fakultetit të Filologjisë. Fakulteti do të forcojë bashkëpunimin ndërmjet palëve të interesit siç janë: menaxhmenti i njësisë akademike, personeli akademik, personeli administrativ dhe teknik, në njërën anë dhe i studentëve, alumni (studentët e diplomuar), shoqërisë civile (OJQ), komunitetit shkollor, komunitetit shkencor, institucioneve qeveritare e lokale, nacionale e ndërkombëtare dhe agjencive të ndryshme, në anën tjetër.

Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe të mësimnxënies mbetet një ndër prioritetet kryesore strategjike. Fakulteti do të punojë për: ngritjen e kapaciteteve akademike dhe administrative; përmirësimin e metodave të matjes dhe monitorimit të rezultateve të të nxënit; zhvillimin profesional të stafit përmes trajnimeve në fushat e didaktikës, hartimit të projekteve kërkimore dhe metodologjisë shkencore; krijimin e grupeve të brendshme për vlerësimin e cilësisë dhe përfshirjen aktive të stafit në zhvillimin e programeve akademike.

Zhvillimi dhe ngritja e cilësisë së punës kërkimore-shkencore do të bëhet edhe me integrimin e hulumtimeve shkencore në procesin akademik dhe me botime në revistën shkencore, me pjesëmarrje në konferenca shkencore të organizuara nga fakulteti, me botimin e monografive dhe teksteve universitare, me përfshirjen e personelit akademik në projekte kombëtare e ndërkombëtare dhe të studentëve në projekte hulumtuese sipas programeve.

Një nga prioritetet e periudhës 2025-2029 do të jetë zhvillimi i kapaciteteve për programin Master në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Gjuhë dhe Letërsi Angleze dhe Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, si dhe avancimi i procesit të ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit akademik, përmes shkëmbimeve dhe bashkëpunimeve me universitete dhe ekspertë të huaj.

Zhvillimi i infrastrukturës, si pajisja me laboratorë dhe me teknologji informative do të ndikojë në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Fakulteti do të zgjerojë bashkëpunimin me komunitetin përmes projekteve të përbashkëta arsimore, kulturore dhe kërkimore, në veçanti me Komunën e Prizrenit dhe drejtoritë e saj përkatëse.

Prof. ass. dr. Dorinë Rakaj,
kryetare e grupit të punës për hartimin e Planit Strategjik të Fakultetit të Filologjisë.

PLANI I VEPRIMIT

Nr.	Objektivit strategjik	Aktivitetet	Masat	Bartësit	Afati kohor	Kostoja (Euro)
Prioriteti specifik 1: Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie						
1.	Ngritja e kapaciteteve akademike në Fakultetin e Filologjisë	Përgatitja dhe shpallja e konkurseve për personel te rregullt akademik në fusha me mungesë; Përzgjedhja sipas kritereve të përcaktuara	Sigurimi i stafit të kualifikuar, rritja e raportit profesor/student dhe përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies Hartimi i analizës së nevojave për staf (raporti profesor/student, mbingarkesa në lëndë, nevoja për fusha të reja studimi) Zhvillimi i një programi mentorimi për stafin e ri akademik (bashkë-mbajtje lëndësh, pjesëmarrje në projekte kërkimore dhe aktivitete ndërkombëtare)	UUHP, FF, Senati	2025-2029	30,000 Muaji

2.	Ngritja e kapaciteteve administrative në mbështetje të cilësisë	Konkurs dhe përzgjedhje e stafit administrativ në fushat e menaxhimit të cilësisë dhe mbështetjes akademike; trajnime për administratën në digjitalizim dhe raportim të cilësisë. Përgatitja dhe shpallja e konkursit për administratë;	Administratë funksionale dhe e trajnuar për zbatimin e proceseve të cilësisë Zhvillimi i një manuali administrativ të fakultetit (proceset, udhëzimet, afatet, formatet e dokumenteve) Krijimi i një mekanizmi të vlerësimit të performancës së stafit administrativ (feedback nga shefat e programeve, studentët dhe dekanati)	UUHP, Zyra e Personelit Senati	2025-2029	1,400 muaji
3.	Ngritja e cilësisë së mësimdhënies dhe matjes së rezultateve	Organizimi i trajnimeve për didaktikë, hartim projektesh shkencore, metodologji kërkimore, dhe përdorim të inteligjencës artificiale në mësimdhënie	Bashkëpunimi me organizma profesionalë; stafi i brendshëm Të paktën 2 trajnime vjetore për 80 % të stafit akademik; përmirësim i vlerësimeve të studentëve për cilësinë. Përfshirja e stafit të brendshëm dhe të jashtëm si trajnerë 90% e syllabuseve përfshijnë metodologji bashkëkohore të të nxënit Të paktën 20% e lëndëve aplikojnë metoda aktive (flipped classroom /	FF, UUHP, ZSC, QPM, OJQ	2025-2029	5,200

			project-based / AI-assisted teaching)			
4.	Përmirësimi i procesit të monitorimit dhe vlerësimit të mësimdhënies Analiza e të dhënave të cilësisë dhe formulimi i raporteve analitike për përmirësim.	Organizimi dhe takime në grupe-degëve për vlerësimin e cilësisë, raporte analitike për përmirësim	Bashkëpunimi profesional i personelit akademik-shkëmbim përvojash Raport vjetor mbi përparimin e cilësisë dhe masat korrigjuese Krijimi i një cikli 3-fazor të monitorimit të cilësisë: 1. Vlerësim 2. Raport analitik 3. Masa korrigjuese Publikimi i një Raporti Vjetor të Cilësisë nga Fakulteti, si pjesë e transparencës institucionale	Fakulteti i Filologjisë, Zyra për Sigurimin e Cilësisë, Programet	2025-2029	000,000
5.	Promovimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies aktive	Zbatimi i metodave “flipped classroom”, “peer learning”, “research-based learning”, “project-based learning”; ndarja e praktikave të mira midis	Rritja e përfshirjes studentore dhe përmirësim i rezultateve të të nxënit Integrimi i teknologjisë digjitale dhe Inteligjencës Artificiale në procesin e të nxënit (AI-assisted learning, mjete interaktive, rubrika digjitale) Ndarja e praktikave të mira ndërmjet departamenteve përmes seminareve	Fakulteti i Filologjisë, Programet	2025-2029	000,000

		departamenteve	të brendshme ("Teaching Excellence Workshops")			
6.	Mbështetje për zhvillimin profesional të personelit akademik	Pjesëmarrje e personelit akademik në trajnime kombëtare/ndërkombëtare dhe projekte si Erasmus+, Horizon Europe, COST Actions, etc.	Deri ne 5 mobilitete trajnimi në vit; certifikata profesionale të fituara Të paktën 1 trajnim ndërkombëtar në fakultet çdo vit, mbajtur nga ekspertë të huaj; Rritje e pjesëmarrjes së stafit në projekte ndërkombëtare me 30% deri në vitin 2029	Fakulteti i Filolgjisë, Programet, Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar	2025-2029	8,000
Prioriteti strategjik 2: Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore						
1.	Ngritja cilësisë së punës kërkimore;	Organizimi i trajnimeve për metodologjinë kërkimore, shkrimin akademik dhe përdorimin e mjeteve digjitale (Zotero, Mendeley, etj.) Pjesëmarrje në rrjete kërkimore ndërkombëtare (COST, Horizon Europe, Erasmus+)	Të paktën 3 trajnime në vit për stafin: metodologji kërkimore (cilësore, sasiore, të kombinuara), shkrim akademik (artikuj, rezyme, abstrakte), përdorimin e mjeteve digjitale (Zotero, Mendeley, AI për kërkim) Pjesëmarrje e fakultetit në projekte ndërkombëtare gjatë periudhës 2025–2029 Rritje 20% në publikime me faktor ndikimi	Fakulteti, UUHP, Zyra e Projekteve	2025-2029	3,000

			Organizimi i një "Jave të Kërkimit Shkencor" çdo vit me prezantime të stafit dhe studentëve			
2.	Integrimi i hulumtimeve shkencore në procesin akademik	Përfshirja e komponentëve kërkimorë në syllabus dhe vlerësime studentore Krijimi i mini-projekteve kërkimore studentore nën mentorim të stafit	50% e lëndëve përfshijnë komponent kërkimor 20 punime studentore prezantohen në konferenca vjetore Organizimi i "Ditës së Kërkimit Studentor" në nivel fakulteti Prezantimi i punimeve më të mira studentore në konferencën vjetore të fakultetit Përfshirja e personelit akademik dhe studentëve në projekte hulumtuese kombëtare dhe ndërkombëtare Krijimi i një databaze me punime kërkimore studentore, e qasshme online Mentorimi i studentëve për publikime, ese shkencore dhe pjesëmarrje në ngjarje akademike	Departamentet, Koordinatorët e programeve	2025-2029	000,000

3.	Promovimi i botimeve shkencore cilësore	Krijimi dhe menaxhimi i revistës shkencore të fakultetit (me ISSN dhe bord ndërkombëtar) Mbështetje për publikime në revista të indeksuara (Scopus, WoS) Përfshirja artikujve me përzgjedhje nga redaksia	Revista publikohet një herë në vit dhe regjistrohet në DOAJ/EBSCO 8 publikime ndërkombëtare në 5 vite 30 artikuj të dorëzuar çdo vit në revistën e fakultetit Pjesëmarrje e autorëve nga të paktën 5 vende të ndryshme në çdo numër të revistës 2 workshop-e vjetore për shkrimin shkencor të stafit dhe studentëve Reduktim 30% i rasteve të plagjiaturës	FF, UUHP, Senati	2026-2029	2,000
4.	Forcimi i bashkëpunimeve shkencore dhe rrjeteve ndërkombëtare	Organizimi i konferencave vjetore ndërkombëtare dhe forumeve shkencore Përfshirja e studiuesve, me përzgjedhje Marrëveshje bashkëpunimi me universitete partnere në BE dhe rajon	1 konferencë vjetore Keynote Speakers ndërkombëtarë gjatë periudhës 2025–2029 Raport vjetor mbi rezultatet kërkimore të konferencave Të paktën një temë e dedikuar për studentët Master në secilën konferencë	FF, UUHP, Senati	2025-2029	1,000

			Abstract Book dhe Proceedings botohen çdo vit me ISBN			
5.	Zhvillimi i kulturës së integritetit kërkimor	Hartimi i planit per monitorim të etikes kërkimore, plagjiaturën dhe përdorimin e IA në kërkim	2 trajnime çdo vit për etikë dhe integritet	FF, UUHP, Senati	2026-2029	2,000

Prioriteti strategjik 3: Zhvillimi i kapaciteteve akademike për programin Master në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Angleze dhe Gjermane						
1.	Hartimi dhe zhvillimi i programeve Master me standarde bashkëkohore	Organizimi i grupeve të punës me personel akademik dhe ekspertë nga fusha për të rishikuar kurrikulat ekzistuese dhe për të hartuar kurrikulat e reja Analiza krahasuese e programeve me universitetet partnere (Gjermani, Austri, Shqipëri, Kosovë)	Tre programe Master në programet e gjuhes shqipe, angleze, dhe gjermane Programe të harmonizuara me standardet e ENQA dhe ESG Përfshirje e komponentit të kërkimit në çdo program	Programet FF, UUHP, Senati	2026 -2029	16,000

		Përfshirja e kërkimit shkencor dhe praktikave profesionale në strukturën e programeve				
2.	Akreditimi dhe zbatimi i suksesshëm i programeve Master	Përgatitja e Raperteve të Vetëvlerësimit (RVV) sipas udhëzimeve të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) Organizimi i procesit të vetëvlerësimit të programeve Koordinimi me ekspertë të jashtëm për përshtatjen e moduleve dhe praktikave	Programe Master të akredituara për periudhën 2026–2030 Raport pozitiv i vlerësimit nga AKA Regjistrimi i gjeneratës së parë të studentëve në vitin akademik 2026/27	Programet FF, UUHP, Senati	2026-2029	16,000
3.	Forcimi i kapaciteteve akademike dhe digjitale të stafit për	Trajnime për mësimdhënie	Të paktën 10 mobilitete në programe si Erasmus+, Horizon Europe,	Fakulteti, ZBN, Zyra e	2026-2029	000,000

	mësimdhënie në nivel Master	kërkimore, përdorim të IA-së në mësimdhënie, metodologji ndërdisiplinore dhe përdorim të Moodle/Teams/Canva për Master Mobilitete Erasmus+ për stafin akademik Përfshirje e profesorëve të jashtëm ndërkombëtarë në mësimdhënie	COST Actions, etj. në vit 80% e stafit të trajnuar në metodologji kërkimore dhe IA-edukim 5 bashkëpunime ndërkombëtare në kornizën e programeve	Cilësisë		
4.	Promovimi dhe ndërkombëtarizimi i programeve Master	Zhvillimi i materialeve promovuese në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe gjermanisht Partneritete me universitete për programe të përbashkëta (double degree) Ftesa për profesorë vizitorë dhe pjesëmarrje në ligjerata dhe/ose panaire akademike	Rritje e regjistrimeve ndërkombëtare me 15% deri në 2029 Nje program i përbashkët Master me universitete të BE-së Rritje e imazhit akademik të Fakultetit të Filologjisë në nivel rajonal	Fakulteti i Filologjisë, ZBN, UUHP, Senati	2026-2029	15,000
Prioriteti strategjik 4: Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit						

1.	Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe institucional	Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja bashkëpunimi me universitete evropiane dhe rajonale Pjesëmarrja në rrjete dhe asociacione akademike ndërkombëtare Shkëmbimi i përvojave me institucione partnere përmes vizitave studimore	Marrëveshje bashkëpunimi të reja deri më 2029 Anëtarësim në të paktën 5 rrjete akademike ndërkombëtare Dy vizita studimore të personelit akademik çdo vit	Fakulteti i Filologjisë, Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Senati	2025-2029	000,000
2.	Shtimi i mobiliteteve të stafit akademik dhe studentëve	Aplikim dhe pjesëmarrje në programet Erasmus+, Horizon Europe, COST Actions, Fulbright, DAAD, etj. Promovimi i mobilitetit përmes ftesave publike dhe trajnimeve informuese Zhvillimi i mekanizmave për	mobilitete studentore dhe mobilitete të stafit në periudhën 2025–2029 Sistemi për njohjen e kredive ndërkombëtare funksional Marrëveshje të reja Erasmus+	Fakulteti, ZBN, Zyra e Projekteve, Koordinatorët e programeve	2025-2029	000,000

		njohjen e kredive dhe përvojave ndërkombëtare				
3.	Ndërkombëtarizimi i programeve studimore	Hartimi i moduleve të përbashkëta në gjuhën angleze Zhvillimi i programeve "Joint Master" dhe "Double Degree" me universitete të BE-së Integrimi i komponentëve ndërkulturorë dhe të mobilitetit në kurrikula	2 programe të përbashkëta Master deri më 2029 2 lëndë në anglisht dhe të ofruara çdo vit Përfshirja e 20% të lëndëve me komponent ndërkombëtar	Fakulteti i Filologjisë, Senati, Koordinatorët e programeve, ZBN	2025-2029	000,000
4.	Promovimi i profilit ndërkombëtar të Fakultetit te Filologjise	Zhvillimi i materialeve promovuese (broshura, web faqe në 3 gjuhë: shqip, anglisht, gjermanisht) Organizimi i aktiviteteve kulturore ndërkombëtare (shkolla verore, ditë kulturore, javë gjuhësh) Pjesëmarrje në	1 faqe dinamike në 3 gjuhë 10 aktivitete ndërkombëtare kulturore çdo vit Rritje e dukshmërisë ndërkombëtare të fakultetit me 30%	Fakulteti i Filologjisë, Zyra e PR, ZBN, programet	2025-2029	6,000

		panaire universitare dhe forume akademike				
5.	Përfshirja e diasporës akademike dhe ekspertëve ndërkombëtarë	Përfshirja e profesorëve vizitorë dhe bashkëpunëtorëve të diasporës Organizimi i ligjëratave dhe seminareve online me profesorë të universiteteve partnere Bashkëpunim në projekte kërkimore me mësimdhënës nga diaspora	3 ligjërata vjetore me profesorë të diasporës 3 projekte kërkimore ndërkombëtare me bashkëautorësi	Fakulteti i Filologjisë, Zyra e PR, ZBN, programet	2025-2029	4,000
Prioriteti strategjik 5: Zhvillimi i infrastrukturës						
1.	Modernizimi i hapësirave studimore dhe administrative	Rikonceptimi i sallave dhe laboratorëve për mësim interaktiv dhe digjital Pajisja e mjediseve me sisteme audio-vizuale dhe pajisje multimediale moderne Përmirësimi i hapësirave për	3 salla të mësimit të pajisura me teknologji moderne Laboratorë gjuhësorë funksionalë deri në vitin 2027 Klasat përfshijnë sistem projektoresh, ekrane smart dhe akses Wi-Fi	FF, UUHP, Zyra e Planifikimit Buxhetor	2029	20,000

		studentë dhe staf (bibliotekë, zyrat, laboratorë gjuhësorë)				
2.	Krijimi i infrastrukturës digjitale për kërkim dhe mësim online	Zhvillimi i një platforme digjitale për mësim online dhe për shpërndarjen e materialeve didaktike (Moodle, Teams) Ndërtimi i një repozitori digjital për publikime dhe punime kërkimore të personelit akademik dhe studentëve Krijimi i laboratorit të gjuhësisë digjitale dhe përkthimit asistuar nga kompjuteri	Platformë online funksionale për 100% të lëndëve Repozitor institucional me 200 materiale shkencore deri në vitin 2029 Laborator "Digital Humanities" aktiv deri në vitin 2028	Fakulteti i Filologjisë, Zyre e IT-së, Zyra e Cilësisë, Rektorati	2029	5,000
3.	Përmirësimi i qasjes në burime akademike dhe bibliotekare	Modernizimi i bibliotekës së fakultetit me katalog elektronik dhe pajisje për skanim/arkivim digjital Abonime në platforma ndërkombëtare	Bibliotekë moderne me sistem elektronik (OPAC) deri më 2027 3 baza të dhënash akademike në dispozicion Hapësirë e re kërkimore funksionale	Fakulteti i Filologjisë, Biblioteka Universitare, Rektorati	2029	000,000

		(EBSCO, JSTOR, Research4Life, Cambridge Core) Krijimi i një hapësire "Reading & Research Room" për studentët Master dhe doktorantë të ardhshëm				
4.	Përmirësimi i infrastrukturës së gjelbër dhe qëndrueshme	Instalimi i ndriçimit dhe sistemeve efikase energjetike Menaxhimi ekologjik i mbeturinave dhe riciklimit në ambientet e fakultetit Krijimi i "Green Campus Corner" për ndërgjegjësim ekologjik	Reduktim i konsumit energjetik me 20% deri më 2028 Raport vjetor për qëndrueshmërinë mjedisore të fakultetit	Fakulteti i Filologjisë, Zyra e Infrastrukturës, Komuna e Prizrenit	2025-2029	6,000
Prioriteti strategjik 6: Kontributi dhe bashkëpunimi me komunitetin dhe komercializimi i kërkimit						
Zhvillimi i partneriteteve me shkolla, komuna dhe institucione lokale		Nënshkrimi i marrëveshjeve bashkëpunimi me drejtoritë arsimore të rajonit	Marrëveshje bashkëpunimi të reja me komuna rajonale 15 aktivitete ndërvepruese me nxënës çdo vit	Fakulteti i Filologjisë, Programet, Zyra e Marrëdhëniev	2025 -2029	1,2000

	Organizimi i aktiviteteve për mentorim, leksione publike dhe ditë promovuese të studimeve në Fakultet Mbështetje për zhvillimin e klubeve gjuhësore dhe letrare në shkolla	Rritje e interesimit për studime gjuhësore në fakultet me 20%	e me Publikun (PR), Komuna e Prizrenit, Komunat rajonale		
Kontributi në zhvillimin kulturor dhe letrar të komunitetit	Organizimi i javëve kulturore, promovimeve letrare dhe ditëve të gjuhëve (shqipe, angleze, gjermane, boshnjake, turke) Bashkëpunim me qendra kulturore dhe biblioteka publike për aktivitete të përbashkëta Promovimi i krijimeve letrare të studentëve dhe stafit në nivel lokal e kombëtar	5 aktivitete kulturore çdo vit Bashkëpunim i qëndrueshëm me 3 institucione kulturore Publikim i përmbledhjeve të krijimtarisë studentore çdo vit	Fakulteti i Filologjisë, Programet, Biblioteka Qendrore, Komuna e Prizrenit, Komunat rajonale	2025-2029	1,000

Zhvillimi i projekteve të shërbimit komunitar dhe qytetarisë aktive	Iniciimi i projekteve "Service Learning" me studentët në bashkëpunim me OJQ lokale Angazhimi i studentëve në fushata të leximit, edukimit mediatik dhe barazisë gjinore Përfshirja e komunitetit në ngjarje akademike dhe trajnime gjuhësore	3 projekte shërbimi komunitar në vit 100 studentë të përfshirë çdo vit në aktivitete sociale 10 trajnime falas për komunitetin lokal	Fakulteti i Filologjisë, Programet, Zyra e Projekteve, OJQ lokale, Studentët e Masterit ZTDT	2026-2029	1,000
Forcimi i bashkëpunimit me median dhe sektorin civil	Bashkëpunime me mediat lokale për promovim të arsimit, kulturës dhe projekteve kërkimore Organizimi i tryezave publike mbi përdorimin e gjuhës, komunikimin digjital dhe etikën mediatike Përfshirje e gazetarëve dhe përkthyesve lokalë në ligjërata si ekspertë në praktikë	1 tryezë publike çdo semestër 5 bashkëpunime me media lokale çdo vit Rritje e njohjes së fakultetit në publik me 30%	Fakulteti i Filologjisë, Zyra e PR, Programet, BKI ZTDT	2026-2029	2,000

Promovimi i dimensionit të gjelbër dhe qëndrueshmërisë në komunitet	Organizimi i fushatave vetëdijesuese për qëndrueshmëri dhe gjelbërim në Prizren Partneritete me organizata ekologjike për aktivitete studentore Përfshirja e temave të qëndrueshmërisë në ngjarjet akademike dhe kulturore	2 fushata mjedisore në vit Bashkëpunim me të paktën 2 OJQ ekologjike Përfshirje e temave “Green Humanities” në aktivitetet studentore	Fakulteti i Filologjisë, Zyra e Infrastrukturës, Komuna, OJQ-të mjedisore, ZTDT, BKI	2026-2029	1,000

Prizren, 2025